

VENDIM
Nr. 51/2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 99, DATË 26.5.2011 “PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR ÇËSHTJET GJINORE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE
NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR
PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË”**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1, 19 pika 2 dhe 21 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me kryetarët e Grupeve Parlamentare të Partisë Demokratike, të Partisë Socialiste dhe të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 99, datë 26.5.2011 “Për ngritjen e nënkomisionit për çështjet gjinore dhe mbrojtjen e fëmijëve në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

I. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:

- | | |
|----------------------------|------------|
| 1. Lajla Pernaska (PD) | - kryetare |
| 2. Albana Vokshi (PD) | - anëtare |
| 3. Kosta Barka (PD) | - anëtar |
| 4. Eglantina Gjermani (PS) | - anëtare |
| 5. Klodiana Spahiu (PS) | - anëtare. |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 13.12.2012